

**KONTRATË PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GMSA” SH.P.K.**

Sot me datë 5 korrik 2023, ortaku themelues :

1. Z Enea GOGA, i biri i Perikliut , shtetas shqiptar, lindur në Durrës 12.10.1989 dhe banues në lagja nr 1 Durres, me karte identiteti nr personal I91012059C,

me vullnetin tim të lirë kam vendosur si më poshtë vijon :

– NENI 1 –

Të themeloj shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar emërtuar ““GMSA” SH.P.K.

Selia legale e shoqërisë është në Lagjja 1, Rruga Taulantia, Zona Kadastrale 8512, Nr.Pasurie 24/179, Durrës. Shoqëria mund të hapë seli ose filiale të tjera në territorin shqiptar ose jashtë tij.

– NENI 2 –

Shoqëria zhvillon aktivitetin e vet në perputhje me këtë kontratë, statutin bashkëlidhur dhe ligjet materiale të Republikës së Shqipërisë.

– NENI 3 –

Objekti i shoqërisë konsiston në aktivitetin :

Te operoje ne fushen e administrimit te tabelave dhe paneleve te reklamave, zhvillimi i strategjive per perdonimin efektiv te masmedias, per blerjen dhe marjen me qira te hapesirave publicitare i te gjitha llojeve.

Pergatitja, printimi i posterave te ndryshem, prodhim ,tregtim i programeve, videove, filmave i te gjitha llojeve.

Organizimi i kongreseve ekspozitave, koncerteve dhe eveneteve i te gjitha llojeve.

Sherbime konsulencë promovimi per shoqeri te ndryshme, realizimi i reklamave te ndryshme,etj. Veprimtari në fushën imobiliare. Zhvillimi dhe administrimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shit-blerja, marrja dhe dhënia me qira e nënqira e tyre. Veprimtari në fushën ndërtimore.

Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me qëllim fitimi me persona juridik e fizik të çfarëdo lloj tipi dhe sido që të janë krijuar ato.

Si dhe të ushtroj çdo lloj aktiviteti tjeter finanziar, tregtare, industrial, ndërtimi , Import Eksporti etj që do të shihen në interes të realizimit të objektit social të saj.

Shoqëria gjithashtu ka të drejtë të japi hua, financime për të tretë, për shoqëri që lidhen me të ose që kontrollohen nga ortakët.

Mundet gjithashtu të marri ndihma ose financime nga çfarëdo enti publik ose privat, shqiptar ose i huaj, nga institute bankare ose nga shoqëri që lidhen me të ose kontrollohen nga ortakët.



- NENI 4 -

Sipas ligjit shqiptar, shoqëria regjistrohet si person juridik dhe kryhen të gjitha formalitetet në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë.

Kohëzgjatja e shoqërisë fiksohet mbi 20 vjet dhe mundet të prishet para kohe ose të zgjatet një ose më shumë herë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

- NENI 5 -

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lek i ndarë në 1 kuote.

Ortakët marrin pjesë në kapital si më poshtë:

1. Z . Enea GOGA, 1 kuote, me vlerë 100.000 lekë ose 100% të kapitalit

- NENI 6 -

Pjesët e pjesëmarrjes në kapitalin shoqëror janë të papjestueshme.

Ato nënshkruhen, depozitothen totalisht nga ortakët në bazë të pjesëmarrjes së secilit në kapital. Çdo pjesë ka të drejtën e një vote. Pjesët janë lirisht të transferueshme vetëm pasi të jetë marrë miratimi me shkrim i të gjithë ortakëve.

- NENI 7 -

Ortaku që dëshiron të shesë pjesët tij të tretëve, duhet të njoftojë më parë ortakët të cilët gjëzojnë të drejtën e parablerjes brenda 30 ditësh nga marrja dijeni. Në rast se blerja bëhet nga të tretë, ortaku që shet duhet t'i komunikojë ortakëve të tjera emrin e blerësit dhe kushtet e shitjes.

- NENI 8 -

Organet drejtuese të shoqërise janë:

- a)Asambleja e ortakëve.
- b)Administratorët.

Aktiviteti, mënyra e organizimit të drejtimit, emërimi ose shkarkimi i drejtuesve si dhe probleme të tjera të rëndësishme do të organizohen në bazë të statutit të shoqërisë që është pjesë përbërëse e kontratës dhe dokumenteve të tjera që do të aprovohen nga Asambleja e ortakëve.

Vendimet e Asamblesë janë të vlefshme në rast se do të aprovojen nga shumica relative e kapitalit. Për probleme që lidhen me mbledhje të jashtëzakonshme, kërkohet vendimi i ortakëve që kanë 50% + 1% të kapitalit.



- NENI 9 -

Asambleja e ortakëve emëron si administrator të shoqërise për një afat pesëvjeçar z. Enea GOGA, mbajtes i kartës së identitetit I 91012059C

Administratori/ët , për probleme të veçanta, mund të delegojnë persona të tjera me prokurë të veçantë ose të përgjithshme.

- NENI 10 -

Aktiviteti finansiar i shoqërises fillon me 1 Janar dhe mbylljet me 31 Dhjetor të çdo viti. Me mbylljen e aktivitetit vjetor do të bëhet bilanci dhe llogaritë fitim/humbje. Fitimi i realizuar, pasi të zbriten rezervat ligjore, do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me vlerën e pjesëmarries së secilit në kapitalin social, ne rast se ortakët nuk vendosin për krijimin e rezervave të tjera.

- NENI 11 -

Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo motivi sipas kritereve të përcaktuara në statut. Në rastin e prishjes së shoqërises për çfarëdo motivi qoftë, emërimi dhe revokimi i likujdatorëve i takon Asamblesë së Ortakëve e cila përcakton edhe kompetencat e tyre.

- NENI 12 -

Mosmarreveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate palët do ti zgjidhin në mirëkuptim ndërmjet tyre. Në rast të kundërt gjykata kopetente per zgjidhjen e tyre do të jetë gjykata e rrëthit Durrës.

Durrës, më 5 korrik 2023

O R T A K U

Enea GOGA

